



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 060/01-135199, datë: 30.Tetor 2018.

Në bazë të nenit 12.pika 2 (d), të Ligjit Nr.03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës datë: 04.Qershor 2008 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 datë: 04.qershor 2008”) nenit 20 alinea 1, pika 4 dhe nenit 22 alineja 2. pika d) të Statutit të Komunes së Pejës, 01.Numër: 09 – 8103 datë 29.09.2008, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: **30.Tetor 2018**, pas shqyrtimit të Draft – Planit Operativ Emergjent Lokal (POEL), në Rekomandim të KPF-ca, muarr:

V E N D I M

Nr.60/ 2018

**MBI MIRATIMIN NË PARIM DHE DHËNJEN NË DISKUTIM PUBLIK TË
DRAFT – PLANIT OPERATIV EMERGJENT LOKAL (POEL)**

I. IPET në Diskutim Publik: Draft – Plani Operativ Emergjent Lokal (POEL) për Komunën e Pejës.

II.Diskutimi Publik zgjat 14 ditë, nga dita e shpalljes – paraqitjes së Draft – Planit në Tabelen e shpalljeve publike dhe në Ueb faqen zyrtare të KK.Pejë.

III. Qytetarët e Interesuar mund të njoftohen me tekstin – përmbajtjen e Draft – Planit të lartë cekur, përmes Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim të KK.Pejë.

IV. Vërejtjet dhe sugjerimet eventuale në Draft – Planin e lartëcekur, mund të bëhen me shkrim dhe të dorzohen përmes Zyrës së pranimit – Arkives, për Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim të KK.Pejë.

V.Vërejtjet dhe sugjerimet duhet të paraqiten vetëm me shkrim dhe në kohën e afatit caktuar me këtë vendim, ngase vërejtjet e paraqitura jashtë afatit nuk do të mirën parasysh.



**KRYESUESI I KUVENDIT
Dr.Islam Husaj**